



Data: 18.05.2018

Ref.: 437/180

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 53-të, të mbajtur më 22 Shtator 2017, mori:

V E N D I M

- I. Revokohet/tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Kolegjit "Iliria", si në vijim:
 - Juridik-Penal, LLM, 60 ECTS
 - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA, 120 ECTS
 - Biznes dhe Ekonomi, MA 120 ECTS
- II. Ndalohet regjistrimi i studentëve në programet e lartshënuara.

A r s y e t i m i

I. KSHC në mbledhjen e 53-të të mbajtur me datë 22 Shtator 2017, ka shqyrtuar listën e stafit akademik të Kolegjit "Iliria" për programet e studimit: Juridik – Penal, LLM (60 ECTS); Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA (120 ECTS) dhe Biznes dhe Ekonomi, MA (120 ECTS), në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve Nr.20/2016, datë 20.09.2016. Duke pasur parasysh se lista e stafit akademik e ofruar nga Kolegji "Iliria" për programet e studimit të cekura më sipër, përbën shkëlqje të legjislacionit në fuqi, përkatësisht nenit 28, pika 2, 3 dhe 4, të UA për Akreditim Nr.20/2016, datë: 20.09.2016, KSHC i AKA-së mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë: 20.09.2016), Neni 28, Pika 1, "AKA e rezervon të drejtën të inespektojë institucionet e akredituara në çfarëdo forme me ose pa paralajmërim.", KSHC i AKA-së, në mbledhjen e 52-të, të mbajtur me datë: 28.07.2017, ka autorizuar zyrën e AKA-së që të bëjë verifikim të dyfishtë të stafit akademik të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të cilët janë të deklaruar si staf i rregullt në Kosovë. Kjo për arsye se një numër i madh i personave të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, pavarësisht dorëzimit të dokumentit zyrtar (në mbledhjet paraprake) se nuk janë të punësuar në shtetin e tyre të origjinës, të njëjtit figurojnë të rregullt në universitetet e shtetit të tyre të origjinës. AKA ka kontaktuar me institucionet e identifikuara në shtetet e origjinës për shtetasit e huaj duke ju kanë drejtuar kërkesë për informatë nëse stafi i njëjtë është i angazhuar në të njëjtën kohë edhe në institucionet e tyre

si staf i rregullt. Bazuar në verifikimin lidhur me angazhimin jashtë Kosovës të stafit akademik shtetas të huaj të Kolegjit "Iliria", të cilët janë deklaruar si stafi i rregullt edhe në institucionin në fjalë në Republikën e Kosovës, pas kontaktimit të Institucioneve përkatëse në vendet e tyre të origjinës ka rezultuar si në vijim:

- Besmir Alushi, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin Mesdhetar në Shqipëri (bartës i programit të studimit: Juridik-Penal, LLM, 60 ECTS);
- Fatmir Tartale, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Albanian University në Shqipëri, (bartës i programit të studimit: Juridik-Penal, LLM, 60 ECTS);
- Nevila Rama, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin Mesdhetar në Shqipëri (bartëse e programit të studimit: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA 120 ECTS);
- Luljeta Kodra, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin Mesdhetar në Shqipëri, (bartëse e programit të studimit: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA 120 ECTS);
- Sabri Hoxha, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Albanian University në Shqipëri, (bartës i programit të studimit: Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, MA 120 ECTS);
- Nderim Zeqiri, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin Shtetëror të Tetovës në Maqedoni (bartës i programit të studimit: Biznes dhe Ekonomi, MA 120 ECTS);
- Marsela Luarasi, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin Bujqësor të Tiranës në Shqipëri Maqedoni (bartëse e programit të studimit: Biznes dhe Ekonomi, MA 120 ECTS);
- Nasir Selimi, është konfirmuar marrëdhënia e rregullt e punës në: Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, Maqedoni (bartës i programit të studimit: Biznes dhe Ekonomi, MA 120 ECTS).

III. Pas marrjes së informatave të mësipërme, AKA ka vërtetuar se stafi akademik përkatës kanë dorëzuar deklaram të rremë në AKA për qëllime të ri/akreditimit të programeve të studimit dhe kjo paraqet shkelje serioze të dispozitave ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. Për më tepër, ky deklaram i rremë përbën shkelje të rëndë të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë, meqenëse AKA në këtë mënyrë ka bërë ri/akreditimin e programeve të studimit bazuar në dëshmi dhe informata të rrejshme.

IV. Procesi i verifikimit të stafit akademik për shtetasit e huaj, është bërë me njoftimin paraprak të IAL-ve nga AKA në lidhje me vendimin e KSHC-së për procesin e verifikimit të këtij procesi. Për më tepër, AKA këtë proces e ka realizuar në transparencë të plotë me gjitha palët e përfshira në këtë proces, përkatësisht me IAL-të në Kosovë, stafin akademik dhe Institucionet relevante në shtetet fqinje dhe vendet tjera.

V. Stafi akademik me rastin e deklaramit të angazhimit të tyre në IAL-të në Kosovë janë të obliguar të dorëzojnë një deklaramtë nën betim, përmes së cilës autorizojnë AKA-në që të bëjë verifikimin e të dhënave të paraqitura në deklaramtat e tyre.

VI. Tërheqja e akreditimit të programeve të studimit, nënkupton që IAL-së i tërhiqet akreditimi për programet respektive dhe i njëjti obligohet që të nis nga fillimi procesin e akreditimit të programeve të studimit, duke mos pasur të drejtë regjistrimin e studentëve të rinj. Studentët e regjistruar në këto programe të studimit në vitet e mëhershme akademike, tani më të tërhequra, do të vazhdojnë me studimet e tyre në përputhje me statutin e institucionit si dhe dispozitat ligjore në fuqi.

VII. Sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë:20.09.2016), në nenin 28, pika 2, përcaktohet se: "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim." Po ashtu në nenin 28, pika 3, përcaktohet se: "AKA mund të tërheq akreditimin në rastet kur ka dëshmi se cilësia e ofrimit të programeve në një ose më shumë fusha për të cilat është dhënë akreditimi është dëmtuar në masë të madhe." Po ashtu në nenin 28, pika 4, përcaktohet se: "Akreditimi mund të tërhiqet po ashtu në rastet kur është përcaktuar se aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumentacione të pasakta të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit."

Bazuar në nenin 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), si dhe dispozitave tjera ligjore, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Iliria";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

